

Hamid Bilali, i cili mes tjerash thotë: **“Jo assesi, medoemos duhet të kemi vullnet të fuqishëm që na ngrisin mbi brengat dhe fatëkeqësitë. Duhet të kujtojmë se ne nuk mund të ndryshojmë asgjë që na e ka caktuar All-llahu [subhanehu ve teala] me hidhërimin, brengën dhe mërrrolat tona. Ne do të humbim shumë nga shëndeti ynë kur do të hidhërohemi, do t'i humbim të tjerët kur do të mërrrolemi, madje mund të humbim fenë, kur hidhërimi dhe brenga ynë do të kontestojnë caktimin e All-llahut [subhanehu ve teala].”**

Çdo herë duhet të jemi të bindur për rregullin, për të cilin na ka treguar Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]: “Dija fitohet me mësim, kurse butësia me trajnim”.

Nëse buzëqeshja nuk është prej natyrës sonë, duhet të mësohemi që të buzëqeshemi dhe të mendo kemi ta bëjmë pjesë të natyrës sonë, pasi që të përkujtojmë frytet e buzëqeshjes dhe të qeshurit”. (shiko libërthin “Buzëqeshu”, fq. 60).

Vëllai im! Kujdesu që të jesh i buzëqeshur me buzëqeshje të sinqertë dhe të pastër, gjë që reflekton atë që ke në zemër, reflekton dashurinë dhe shoqërimin me njerëz, kujdesu nga buzëqeshja artificiale, që pas saj fshihet urrejtja dhe zilia.

Ibn Kajjimi [rahimehull-llah] duke folur për rëndësinë e buzëqeshjes thotë: **“Njerëzit ikin nga njeriu i vrazhdë edhe nëse arrijnë grada të larta në fe. Vall-llahi sa zemra i tërhjek butësia dhe njeriu simpatik, sepse njerëzit e rëndë nuk janë miqtë e veçantë të All-llahut [subhanehu ve teala]. Askush nuk i rëndon zemrat e njerëzve të sinqertë dhe të vërtetë, përpos nga ky defekt. Kjo mënuhë njeriut i jep ëmbëlsi, butësi dhe simpati. I sinqertë prej tyre është ai që i ngjallë njerëzit dhe silltet butë me ta, ai që ka larguar prej vehtes barrën dhe llomin e natyrës”.**

Imam Ibn Ujejne [rahimehull-llah] thotë: **“Buzëqeshja është rrjeti i dashurisë, kurse mirësia është diç e lehtë: Fytyrë e buzëqeshur dhe fjalë e butë”.**

Përshtati: Bekir Halimi

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fle-tushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



Buzëqeshu!

Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë: **“Ju nëse nuk keni mundësi t'i kaploni njerëzit me pasuri, mund t'i kaploni me fytyrë të hapur dhe moral të mirë”.** (Muslimi). Gjithashtu thotë: **“Asnjë vepër të mirë mos e nënçmoni, edhe poqese është takimi i vëllait tuaj me fytyrë të buzëqeshur”.** (Hakimi dhe të tjerët. Sahih).

Xherir ibn Abdull-llahi [radijall-llahu anhu] thotë: **“Asnjherë Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk më ka shikuar me fytyrë të mrrrolur, dhe çdo herë që më ka parë më ka buzëqeshur në fytyrën time”.** (Buhariu).

Buzëqeshja ka elegancë dhe bukuri, shpreh rehatinë dhe gëzimin në fytyrën e njeriut, madje Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] për këtë vepër ka garantuar shpërblim duke thënë: **“Buzëqeshja në fytyrën e vëllaut tënd është sadaka”.**

Dhe ka shtuar: **“Ju nëse nuk keni mundësi t'i kaploni njerëzit me pasuri, mund t'i kaploni me fytyrë të hapur dhe moral të mirë”.** (Muslimi).

Imam Buhariu [rahimehull-llah] i ka përmbledhur të gjitha hadithet e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në një kapitull, të cilin e ka emërtuar

njerëzve apo përmendja e saj në shenjën nënçimi.

O vëllezër të mi, vëreni ajetet e ndershme, se si All-llahu [subhanehu ve teala] sadakadhënësit i dhuron urtësinë:

“O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga Ajo që u dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga Ajo, e që ju nuk do ta pranoni atë për vete vetëm symbyllas. E, dine se All-llahu [subhanehu ve teala] s'ka nevojë për ju, është i Madhëruar.

Djali ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqia, e All-llahu [subhanehu ve teala] ju garanton falje (mëkatësh) e begati; All-llahu [subhanehu ve teala] është dhurues i madh, është i dijshtëm.”

“Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, përveç të mençurëve, këtë nuk e kupton kush.” (El-Bekare: 267-269).

Ka mbetur vetëm një vështrim i vogël. Shpresoj se do ta vëreni mirë dhe do ta kuptoni. Tregtari e fsheh gjithmonë kapitalin (fitimin) e pasurisë së tij, po bile edhe e numëron ndër gjërat më sekrete, të cilën asnjëri nuk guxon që ta

dijë, po, edhe nëpunësi e fshehë pagën e tij mujore, duke mos i treguar asnjërit për te.

Andaj, si gjen sadakadhënësi vështirësi që sadakanë e tij ta bëjë të fshehtë, duke shpresuar më shumë se sa që shpreson tregtari nga tregtia e tij dhe më shumë se sa që arrin paga e nëpunësit të tillë.

Fjala e të Madhëruarit është e qartë në mbivlerësimin e sadakasë së fshehtë ndaj asaj që jepet haptazi, dhe se Ajo (e fshehta) i largon (veprat) të këqiat.

“...po nëse ato u jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju dhe Ai ua largon (me punë të mira) të këqiat. All-llahu është i njohur hollësisht për veprat tuaja.” (El-Bekare: 271).

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fle-tushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 32 23-654
1000, Shkup



**Frutet e pasura...
të lëmoshës
(SADAKASË)
së fshehtë**

“Kapitulli i buzëqeshjes dhe qeshjes”. Këto hadithe janë argumente për buzëqeshjen, për të cilën kujdeset Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Poashtu edhe Imam Muslimi [rahime-hull-llah] ka përmbledhur hadithe, të cilave Imam Neveviu u ka dhënë një kapitull me titull **“Kapitulli i vlerave”**; tema që flet për “Buzëqeshjen dhe sjelljen e tij të mirë”...

Të gjithë këto sqarojnë aspektet e buzëqeshjes së Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Të tillë kanë qenë edhe sahabet e tij, [radijall-llahu anhum].

I kanë thënë Omerit [radijall-llahu anhu]: **A janë qeshur shokët e Muhammedit** [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]? Tha: **“Po, kurse besimi ishte më i fuqishëm në zemrat e tyre se sa kodrat e larta”.**

Muhamed Kutbi thotë: **“S’mjafton vetëm pasuria për të mbledhur zemrat e as organizmat ekonomike ose gjendja sociale, medoemos duhet ta shoqëroj edhe shpirti i ndieshëm, i cili merr forcën e vet nga Mëshira e All-llahut [subhanehu ve teal], e ajo është dashuria. Dashuri e cila reflekton buzëqeshjen nga zemra, zgjërohet gjoksi, lirohet energji pozitive dhe njeriu e takon vëllaun e tij me fytyrë të buzëqeshur”.**

Pengesat e buzëqeshjes

Ti shohim pengesat kryesore të buzëqeshjes...

1- Mendimi se kjo është pjesë e seriozitetit.

Disa mendojnë se mosbuzëqeshja është pjesë e seriozitetit, të cilën doemos duhet ta ketë një personalitet serioz dhe është plotësim i fesë. Ky mendim nuk është në vend sepse njerëzit sipas natyrës anojnë dhe i dojnë ata që u buzëqeshin në fytyrë. Kurse serioziteti, a ka njeri më serioz se Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Semak ibn Harbi [radijall-llahu anhu] tregon duke thënë:

I thashë Xhabir ibn Semures: **A e shoqëroje Pejgamberin** [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]? Tha: **Po, edhe ate shumë herë.**

“Ai nuk ngritej nga vendi ku e falte sabahun deri sa të lindte dielli, e kur lindte dielli ngritej. Pastaj bisedonin, e flitnin për kohën e injorancës dhe qesheshin, kurse ai buzëqeshte”. (Muslimi).

Kjo buzëqeshje aspak nuk ia ulte pozitën Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], por kjo është butësi, e cila kur gjindet në një gjë, ajo zbukurohet, e kur ngritet nga ndonjë gjë, ajo shëmtohet.

2- Frika nga ngurtësimi i zemrës.

Disa njerëz e përziejnë shpeshimin e

të qeshurit, për të cilën Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka thënë se e vdes zemrën dhe rëndësisë së buzëqeshjes dhe qeshjes mesatare, për të qenë mesatar dhe për të larguar brengën dhe për t’i fituar të tjerët... Duhet të kujdesemi nga shprehjet e gabuara të disa sufive, të cilët kur përshkruajnë ndokend për asketizmin e tij thonë “asnjëher s’ka qeshur”, “çdo herë shihej i brengosur”, kurse kjo është në kundërshtim me natyrën dhe sunnetin e Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Hadithi të cilin e transmeton Ibn Maxheja me sened të vërtetë: **“Mos e teproni me të qeshur, sepse teprimi në të qeshur e vdes zemrën”.** Nuk ka ndaluar të qeshurit, por ka ndaluar teprimin në të qeshur.

3- Edukata e njeriut.

Edukata e njeriut luan rol të madh në jetën e njeriut, ai që lind nga dy prindër që hidhërohen shumë, pakësohet buzëqeshja në jetën e tij, ashtuqë shumë rrallë mund ta shohish të buzëqeshur, kjo normalisht mvaret nga ambienti që e rrethekon.

4- Natyra e vrazhdë e njeriut, mendimi i keq për njerëzit, sjellja e rëndë

Të gjitha këto elemente e shtyejnë njeriun që të buzëqeshet pak.

A duhet t’i dorëzohemi realitetit tonë? Për këtë pyetja ka folur shejh Abdul-

Kur të gjithë njerëzit të dinë se ti je ai i cili i ke dhënë sadaka haptazi të varfërit, të ngratit apo gruas së vejë, a thua vallë se dituria e tyre mbi këtë ty të realizon diç nga synimet e tua prej sadakasë siç është pastrimi dhe ngritja shpirtërore, të fituarit e shpërblimit apo shumëfishimin i pasurisë sate?

Të dhënurit e sadakasë haptazi nuk realizon dot gjë nga **Ajo** që e përmendëm më lart, sepse të diturit e njerëzve për sadakanë e tillë nuk ndikon që ato ta kompenzojnë atë që ti e ke dhënë e as që posedojnë dot fuqi për të të shpërblyer për të. Pastaj, edhe shpirti yt nuk do të mund të ngritet me sadakanë e tillë, por përkundrazi, ndoshta atë e kaplon syfaqësia apo ndjenja se vetëm ai është bamirës dhe bujar.

Në anën tjetër të fshehurit e sadakasë nuk menjanon dot gjë nga frutet e lartëpërmendura, po bile i shton dhe i zmadhon ato.

All-llahut i Madhëruar e garanton shumëfishimin e sadakasë së fshehtë. Vetëm Ai, i Lartëmadhëruari, posedon fuqi që ta shumëfishoj atë si dhe gjërat tjera. Ai e din sadakanë edhe në qoftë se është plotësisht e fshehur nga të gjithë, ngase Ai i Madhëruari është

posedues i gjithësisë, andaj nuk ka vend për frikë dhe dyshim.

“...e çkado që t’u jepni të tjerëve nga pasuria, ajo do t’u kompensohet në mënyrë të plotë duke mos u dëmtuar ju.” (El-Bekare: 272).

“All-llahu e di për atë që e keni dhënë nga pasuria ose keni zbatuar ndonjë premtim, e për ata mëkatarët nuk ka ndonjë ndihmëtarë. Nëse lëmoshat i jepni haptazi, ajo është mirë, por nëse ato u jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju dhe Ai (me punë të mira) ua largon të këqiat. All-llahu është i njohur hollësisht për veprat tuaja.” (El-Bekare: 270-271).

“Pra çkado që të jepni nga pasuria, s’ka dyshim se atë All-llahu e di shumë mirë.” (El-Bekare: 273).

Fruti i dytë, pas shumëfishimit të pasurisë në këtë botë, është shpërblimi i madh në botën e ahiretit, gjë e cila është e vërtetuar nga ana e All-llahut [subhanehu ve teal], ngase vetëm Ai posedon fuqi për të shpërblyer në këtë mënyrë. Vetëm Ai e dhuron këtë shpërblim dhe vetëm Ai është që futë në Xhennet dhe shpëton nga zjarri. Të dhënurit e sadakasë haptazi apo fshehurazi, nuk e mënjanon sadakad-

hënësin nga shpërblimi i tillë.

“Jepni Për të varfërit që janë të angazhuar në rrugë të All-llahut dhe nuk kanë mundësi të gjallërojnë me tokë, duke qenë se ata lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të rraskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i mërzhisin njerëzit. Pra çkado që të jepni nga pasuria, s’ka dyshim se atë All-llahu e di shumë mirë.

Ata, të cilët pasurinë e vet e shpërndajnë (në rrugë të Zotit) natën dhe ditën, fshehurazi ose haptazi, ata shpërblimin e vet e kanë te Zoti i tyre dhe për ta nuk ka frikë, as pikëllim.” (El-Bekare: 273-274).

Sa përgëzime të lumtura dhe të mëdha!

1. Ata shpërblimin e vet e kanë te Zoti i tyre,
2. Dhe për ta nuk ka as frikë,
3. E as pikëllim.

Fruti i tretë është pastrimi i shpirtit, gjë e cila realizohet më së miri kur realizohet sadakaja në mënyrë të fshehur, sepse, në atë mënyrë, nijeti bëhet i pastër dhe i sinqertë ndaj All-llahut [subhanehu ve teal] duke mos e ndotur dot syfaqësia mburrja me të para